

**MARRËVESHJE NDËRMJET
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË AUSTRISË
DHE
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR
BASHKËPUNIMIN DHE NDIHMËN E NDËRSJELLTË NË FUSHËN
DOGANORE**

Qeveria e Republikës së Austrisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, këtej e tutje referuar si Palë Kontraktuese;

Duke konsideruar se shkeljet ndaj legjislacionit doganor janë të dëmshme për interesat ekonomike, fiskale dhe tregtare, si dhe për shëndetin publik të vendeve të tyre respektive;

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e vjeljes së saktë të detyrimeve doganore dhe të taksave të tjera mbi importimin dhe eksportimin e mallrave, si dhe përcaktimin e saktë të vlerës dhe origjinës së këtyre mallrave;

Duke njohur nevojën për bashkëpunim ndërkombëtar në çështjet e lidhura me administrimin dhe ushtrimin e Legjislacionit Doganor;

Të bindur se masat kundër shkeljeve doganore mund të bëhen më efektive nëpërmjet bashkëpunimit ndërmjet Autoriteteve të tyre kompetente Doganore;

Duke marrë në konsideratë detyrimet e vendosura sipas Konventave Ndërkombëtare të pranuara ndërkohë apo të zbatuara nga Palët Kontraktuese dhe duke marrë në konsideratë gjithashtu Rekomandimet e Këshillit të Bashkëpunimit Doganor mbi Asistencën e Ndërsjelltë Administrative të 5 Dhjetorit 1953;

Ranë dakort për sa më poshtë vijon:

PËRKUFIZIME

Neni 1

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje,

1. "Autoritet Doganor" do të thotë, në Republikën e Austrisë -- Ministria Federale e Financave, dhe në Republikën e Shqipërisë – Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e Ministrisë së Financave.
2. "Legjislacion Doganor" do të thotë çdo dispozitë ligjore ose rregullore të zbatuara në territoret e Palëve Kontraktuese lidhur me importin, eksportin dhe tranzitin e mallrave dhe mbi detyrimet doganore, taksave e të tjera, duke përfshirë masat në fushën e ndalimeve, kufizimeve dhe kontrollit.
3. "Shkelje Doganore" do të thotë çdo shkelje apo përpjekje për shkelje të Legjislacionit Doganor.
4. "Autoritet Kërkues" do të thotë Autoriteti Doganor që bën një kërkesë për ndihmë në çështjet doganore në përputhje me këtë Marrëveshje ose i cili merr ndihmë spontane.
5. "Autoritet i Kërkuar" do të thotë Autoriteti Doganor i cili merr një kërkesë për ndihmë në çështjet doganore në përputhje me këtë Marrëveshje ose i cili jep ndihmë spontane.
6. "Droga Narkotike" do të thotë çdo substancë, natyrore apo sintetike, të parashikuara në Listat I dhe II të Konventës Unike të Kombeve të Bashkuara të 1961 mbi Drogat narkotike, e ndryshuar nga Protokollin e 1972.
7. "Substanca Psikotrope" do të thotë çdo substancë, natyrore apo sintetike, ose çdo material natyror, i paraqitur në Listat I, II, III dhe IV të Konventës së Kombeve të Bashkuara të 1971 mbi Substancat Psikotrope.
8. "Prekursorë" do të thotë çdo substancë kimike e kontrolluar e përdorur në prodhimin e drogave narkotike dhe substancave psikotrope, përfshirë në Listat I dhe II të Konventës së Kombeve të Bashkuara të 1988 Kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Substancave Psikotrope.
9. "Shpërndarje e Kontrolluar" do të thotë metoda e lejimit të ngarkesave të paligjshme apo të dyshuara të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve, apo substancave zëvendësuese të tyre për të hyrë, dalë ose lëvizur në territorin e shtetit të

njërës palë kontraktuese apo më shumë vendeve, me dijeninë dhe nën kontrollin e autoriteteve kompetente të palëve kontraktuese, me synim identifikimin e personave të përfshirë në kryerjen e shkeljeve.

10. "Detyrime Doganore" do të thotë të gjitha detyrimet, taksat, pagesat dhe/ose detyrime të tjera të cilat ushtrohen dhe grumbullohen në territoret e Palëve Kontraktuese, në zbatim të Legjislacionit doganor.
11. "Informacion" do të thotë, inter alia, raporte, regjistrime, dokumenta dhe dokumentacion, i kompjuterizuar ose jo, si dhe kopje të autentifikuara të këtyre.
12. "Të Dhëna Personale" do të thotë i gjithë informacioni i lidhur me një individ të identifikuar apo të identifikueshëm.

QËLLIMI I MARRËVESHJES

Neni 2

1. Palët Kontraktuese do të ndihmojnë njëra-tjetrën, sipas mënyrës dhe kushteve të caktuara në këtë Marrëveshje, me synim sigurimin e zbatimit korrekt të Legjislacionit Doganor, e në veçanti për parandalimin, hetimin, shtypjen dhe dënimin e çdo shkeljeje doganore.
2. E gjithë ndihma sipas kësaj Marrëveshjeje do të jepet në përputhje me legjislacionin kombëtar të Palës Kontraktuese të Kërkuar. Ndihma siç parashikohet në paragrafin 1, duhet të jepet për përdorim në të gjitha proceset në Palën Kontraktuese Kërkuese, si ato ligjore, administrative dhe hetimore dhe do të përfshijë, por nuk do të kufizohet vetëm në proceset mbi klasifikimin, vlerën, origjinën dhe procedura të tjera të lidhura me ushtrimin e Legjislacionit Doganor dhe procedime të tjera që përfshijnë gjoba, dënime apo sanksione.
3. Ndihma e ndërsjelltë sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të ndikojë në dispozitat e zbatueshme lidhur me ndihmën e ndërsjelltë në fushën penale, por Administratat Doganore të Palëve Kontraktuese mund të kërkojnë apo mundësojnë ndihmë të ndërsjelltë gjatë çdo hetimi apo në lidhje me çdo proces ligjor apo administrativ të kryer nga Administrata Doganore e njërës prej Palëve Kontraktuese.
4. Ndihma e Ndërsjelltë sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të mbulojë arrestimin e personave ose rikuperimin e detyrimeve dhe taksave mbi eksportet apo importet, apo dënimeve të ndryshme ose gjobave të tjera.

NDIHMA SIPAS KËRKËSES

Neni 3

1. Sipas kërkesës së Autoritetit Kërkues, Autoriteti i Kërkuar do ta furnizojë atë me të gjithë informacionin përkatës për t'i mundësuar sigurinë se Legjislacioni Doganor është zbatuar korrektësisht, si dhe me informacion lidhur me akte të kryera apo planifikuara të cilat shkelin ose mund të shkelin Legjislacionin Doganor.
2. Sipas kërkesës së Autoritetit Kërkues, Autoriteti i Kërkuar do të informojë:
 - nëse mallrat e eksportuara nga territori i njëjës prej Palëve Kontraktuese janë importuar saktësisht në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, duke specifikuar kur është e nevojshme, procedurat doganore nën të cilat janë vendosur këto mallra;
 - nëse mallrat e importuara në territorin e njëjës prej Palëve Kontraktuese janë eksportuar saktësisht nga territori i Palës tjetër Kontraktuese, duke specifikuar kur është e nevojshme, procedurat doganore nën të cilat janë vendosur këto mallra.
3. Sipas kërkesës dhe brenda fushës së mbulimit të kompetencave dhe mundësive të veta, Autoriteti Doganor i Kërkuar do të mbajë nën mbikqyrje speciale për një periudhë të caktuar kohore lëvizjen e mallrave të njohura apo dyshuara se kanë qenë objekt i shkeljeve doganore, duke përfshirë lëvizjen e personave apo mjeteve të transportit.
4. Autoritetet Doganore të Palëve Kontraktuese, sipas kërkesës, do të mundësojnë dokumentacion lidhur me transportin dhe ngarkesat e mallrave, duke indikuar vlerën, origjinën, vendndodhjen dhe destinacionin e këtyre mallrave.

NDIHMA SPONTANE

Neni 4

Palët Kontraktuese, brenda kompetencave të tyre do t'i mundësojnë njëra-tjetrës ndihmë, nëse ato e konsiderojnë këtë të nevojshme për zbatimin korrekt të Legjislacionit Doganor, veçanërisht kur ato kanë informacion lidhur me:

- aktivitete që përbejnë ose duket se mund të përbejnë një shkelje të Legjislacionit Doganor brenda territorit të Palës tjetër Kontraktuese;

- mjete dhe metoda të reja të përdorura në kryerjen e shkeljeve doganore;
- mallrat e njohura se përbëjnë subjektin e një shkeljeje të Legjislacionit Doganor;
- mjetet e transportit lidhur me të cilat ka baza të arsyeshme për të besuar se janë përdorur, përdoren apo mund të përdoren në shkeljen e legjislacionit doganor;
- marrjen në konsideratë dhe testimin e pajisjeve apo procedurave të reja.

MBIKQYRJA E PERSONAVE, MALLRAVE, MJETEVE TË TRANSPORTIT DHE VENDEVE

Neni 5

Sipas kërkesës së Autoritetit Kërkues, Autoriteti i Kërkuar, brenda kufijve të dispozitave të veta ligjore dhe administrative dhe për aq sa ka mundësi, do të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të siguruar mbikqyrjen speciale mbi:

1. personat fizike apo juridike për të cilët ka baza të arsyeshme për të besuar se ata janë përfshirë ose janë duke u përfshirë në një shkelje të Legjislacionit Doganor në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese;
2. mallrat që janë transportuar apo mund të transportohen në një mënyrë të tillë që jep baza të arsyeshme për të besuar se ato kanë qëllim të përdoren në një shkelje të Legjislacionit Doganor në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese;
3. mjetet e transportit të dyshuara se janë përdorur në një shkelje doganore brenda territorit të Palës Kontraktuese Kërkuese;
4. vendet ku mallrat kanë qenë grumbulluar ose mund të grumbullohen në një mënyrë të tillë që jep arsye bindëse për të besuar se ato lidhen me një aktivitet që mund të rezultojë në një shkelje doganore në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese.

FORMA DHE PËRMBAJTJA E KËRKESAVE

Neni 6

1. Kërkesat në zbatim të kësaj Marrëveshjeje do të bëhen me shkrim. Dokumentat e nevojshëm për ekzekutimin e këtyre kërkesave duhet të shoqërojnë kërkesën. Kur është e

nevojshme, për shkak të urgjences së situatës, mund të pranohen edhe kërkesa gojore, por këto duhet të konfirmohen menjëherë me shkrim. Dokumentat e përmendura në këtë Marrëveshje mund të zëvendësohen nga informacion i kompjuterizuar i prodhuar në çfarëdolloj forme për të njëjtin qëllim.

2. Kërkesat në përputhje me paragrafin 1 të këtij Neni do të përfshijnë informacionin e mëposhtëm:

- Autoritetin Kërkues që bën kërkesën;
- masat e kërkuara;
- objektin dhe shkakun për kërkesë;
- tregues sa më të saktë dhe të zgjeruar të mundur mbi personat fizike dhe juridike me të cilët lidhet çështja;
- një përshkrim të përmbledhur të çështjes që po trajtohet si dhe dispozitat ligjore dhe administrative të përfshira, dhe
- një përmbledhje të fakteve që kanë lidhje si dhe të kërkimeve të bëra ndërkohë.

3. Kërkesat do të transmetohen në gjuhën zyrtare të Autoritetit të Kërkuar ose në një gjuhë tjetër të pranuar nga Autoriteti i Kërkuar.

4. Origjinalet e dosjeve, dokumentave dhe materialeve të tjera do të kërkohen vetëm në rastet kur kopjet janë të pamjaftueshme. Sipas një kërkesë specifike, kopje të këtyre dosjeve, dokumentave dhe materialeve të tjera duhet të autentifikohen përkatësisht.

5. Origjinalet e dosjeve, dokumentave dhe materialeve të tjera që janë dërguar duhet të rikthehen me mundësinë me të parë.

6. Nëse një kërkesë nuk përmbush detyrimet formale, mund të kërkohet korrektimi apo kompletimi i kërkesës, gjithsesi mund të porositet marrja e masave paraprake.

MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Neni 7

1. Ndihma do të përmbushet nëpërmjet komunikimit direkt ndërmjet Autoriteteve respektive Doganore duke themeluar dhe mbajtur rrugë komunikimi ndërmjet tyre me synim lehtësimin e shkëmbimit të shpejtë dhe të sigurtë të informacionit.
2. Në rastin kur Autoriteti Doganor i Palës Kontraktuese të Kërkuar nuk është autoriteti kompetent për t'iu përgjigjur kërkesës, ai, pas konsultimeve të nevojshme, do t'i transmetojë kërkesën Autoritetit kompetent i cili do të veprojë me kërkesën sipas kompetencave të veta nën legjislacionin kombëtar, ose do të këshillojë Autoritetin Kërkuar mbi procedurat e sakta që duhen ndjekur lidhur me një kërkesë të tillë.

EKZEKUTIMI I KËRKESAVE

Neni 8

1. Kërkesat për ndihmë do të ekzekutohen në përputhje me dispozitat ligjore dhe administrative të Palës Kontraktuese të Kërkuar.
2. Autoriteti i Kërkuar do të proçedojë, brenda kufijve të kompetencave dhe mundësive të veta, si te ishte duke vepruar për llogari të vet.
3. Autoriteti Doganor i çdo Pale Kontraktuese, sipas kërkesës së Autoritetit Doganor të Palës tjetër Kontraktuese, do të zhvillojë çdo hetim të nevojshëm brenda kompetencave të veta, duke përfshirë pyetjen e eksperteve, dëshmitarëve ose të personave të dyshuar se kanë kryer një shkelje doganore, dhe do të ndërmarrë verifikime, inspektime dhe kërkime për gjetje faktesh në lidhje me çështjet e përmendura në këtë Marrëveshje.
4. Autoriteti i Kërkuar mund të lejojë zyrtare të caktuar nga Autoriteti Kërkuar për të qenë të pranishëm në territorin e Palës Kontraktuese të Kërkuar, kur zyrtaret e vet janë duke kryer kërkime në interes të Autoritetit Kërkuar, duke përfshirë praninë në këto kërkime. Zyrtarët e caktuar do të jenë të pranishëm dhe do të kenë vetëm rol këshillues dhe nuk do të ushtrojnë komtetencat e dhëna zyrtarëve të Autoritetit të Kërkuar nga legjislacioni kombëtar i Palës Kontraktuese të Kërkuar. Ata, gjithsesi, për qëllimin e vetëm të kryerjes së kërkimeve, në prani e nëpërmjet zyrtarëve të Autoritetit të Kërkuar, mund të kenë akses në të njëjtat vende dhe dokumentacione ku kanë akses zyrtarët e Autoritetit të Kërkuar.

5. Zyrtarët e Autoritetit Kërkues, të autorizuar për të hetuar shkeljet e Legjislacionit Doganor, mund t'u kërkohen zyrtarëve të Autoritetit të Kërkuar të shqyrtojnë të dhënat që kanë interes, regjistrat dhe dokumente të tjerë ose të dhëna të kompjuterizuara dhe të marrin kopje të tyre ose t'u mundësohet çdo informacion lidhur me shkeljet.
6. Kur zyrtarët e Autoritetit Kërkues janë të pranishëm në territorin e Palës Kontraktuese të Kërkuar në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, ata duhet të jenë në gjendje gjithnjë të identifikohen dhe do të jenë përgjegjës për çdo shkelje që mund të kryejnë.
7. Autoriteti Kërkues, nëse e kërkon, mund të këshillohet për kohën dhe vendin e masave që do të ndërmerren në përgjigje të një kërkese, në mënyrë që të mund të koordinohen masa.

EKSPERTET DHE DËSHMITARËT

Neni 9

1. Një zyrtar i Autoritetit të Kërkuar mund të autorizohet për t'u paraqitur, brenda limiteve të autorizimit të dhënë, si ekspert apo dëshmitar në proceset ligjore apo administrative lidhur me çështjet që kanë lidhje me këtë Marrëveshje në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese, dhe për të prodhuar dosje, dokumente ose kopje të autentifikuara të tyre që mund të nevojiten për proceset.
2. Kërkesa për paraqitje duhet të përshkruajë llojin e procesit si dhe statusin nën të cilin ky zyrtar është thirrur për të dëshmuar.

DËRGIMI I DOKUMENTEVE

Neni 10

1. Sipas kërkesës së Autoritetit Kërkues, Autoriteti i Kërkuar, në përputhje me dispozitat dhe rregulloret e veta ligjore do të ndërmarrë të gjitha masat me synim dërgimin e gjithë dokumentave dhe njoftimin e gjithë vendimeve që dalin nga Autoriteti Kërkues dhe që janë brenda qëllimit të kësaj Marrëveshjeje për një person, të regjistruar apo të vendosur në territorin e Palës Kontraktuese të Kërkuar.
2. Kërkesat për dërgimin e dokumentave apo njoftimeve të vendimeve do të bëhen me shkrim në një gjuhë zyrtare të Palës Kontraktuese të Kërkuar ose në një gjuhë të pranueshme nga Autoriteti i Kërkuar. Në vazhdim, përmbajtja e dokumentit zyrtar që do

të njoftohet duhet të shoqërohet nga një përkthim i autentifikuar në një gjuhë zyrtare të Palës Kontraktuese në të cilën është vendosur Autoriteti i Kërkuar.

3. Kjo dërgese do të evidentohet nga një fletë marrje prej të adresuarit e cila mban datën e dërgesës ose nga një çertifikatë që përshkruan mënyren dhe datën e dërgesës.

PËRJASHTIME NGA DETYRIMI PER TË DHENË NDIHMË

Neni 11

1. Në rastet kur Pala Kontraktuese e Kërkuar është e mendimit se përgjigja ndaj një kërkesë do të shkelte sovranitetin, sigurinë, politikat publike ose çdo interes tjetër thelbësor kombëtar ose do të shkelte një sekret tregtar, industrial apo profesional, ndihma mund të refuzohet ose përgjigja mund të jepet në bazë të përmbushjes së disa kërkesave apo kushteve të vendosura. Ndhma mund të refuzohet gjithashtu nëse kërkesa përmban rregulla taksash apo valutore të tjera nga rregulloret lidhur me detyrimet doganore.
2. Ndhma mund të shtyhet nga Autoriteti i Kërkuar nëse ajo ndërhyt në një hetim në vazhdim e sipër, proces apo gjykim çështjeje. Në një rast të tillë, Autoriteti i Kërkuar do të konsultohet me Autoritetin Kërkues për të përcaktuar nëse ndihma do të jepet bazuar në termat apo kushtet që mund të vendosë Autoriteti i Kërkuar.
3. Kur Autoriteti Kërkues kërkon ndihmë i cili vete nuk do të ishte në gjendje ta jepte nëse i kërkohej dicka e tillë, ky Autoritet do ta theksojë këtë fakt në kërkesën e vet. Do të varet nga Autoriteti i Kërkuar vendimi se si do t'i përgjigjet një kërkesë të tillë.
4. Në rastet kur ndihma mohohet apo shtyhet, arsyet për mohimin apo shtyrjen duhet t'i njoftohen Autoritetit Kërkues me shkrim, pa vonesë.

KOSTOT

Neni 12

1. Palët Kontraktuese do të heqin dore normalisht nga pretendimet për rimbursimin e kostove të lindura gjatë ekzekutimit të Marrëveshjes, me përjashtim të shpenzimeve për dëshmitaret, ekspertet dhe kostot e përkthyesve që nuk janë nëpunës shteti.
2. Nëse për ekzekutimin e kërkesës kërkohen shpenzime të një natyre thelbësore dhe të jashtëzakonshme, Autoritetet Doganore të Palëve Kontraktuese do të konsultohen për të

përaktuar termat dhe kushtet sipas të cilave do të ekzekutohet kërkesa, si dhe mënyren sesi do të mbuloen shpenzimet.

KONFIDENCIALITETI DHE PËRDORIMI I INFORMACIONIT

Neni 13

1. Çdo informacion i komunikuar në çfarëdolloj mënyre në zbatim të kësaj Marrëveshjeje do të jetë i një natyre konfidenciale. Do të mbulohet nga detyrimi i sekretit zyrtar dhe do të gezojë të njejtën mbrojtje që i jepet informacionit të njëjtë të aplikuar në Palën Kontraktuese që e ka marre atë në zbatim të ligjeve të veta.
2. Të Dhënat Personale mund të transmetohen vetëm nëse niveli i mbrojtjes i parashikuar nga legjislacioni i Palëve Kontraktuese është ekuivalent. Palët Kontraktuese do të sigurojnë të paktën një nivel mbrojtjeje bazuar në parimet e përmendura në Aneksin e kësaj Marrëveshjeje, i cili përbën një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.
3. Informacioni i marrë gjatë ndihmës së ndërsjelltë mund të përdoret vetëm për qëllimet e specifikuar në këtë Marrëveshje, duke përfshirë përdorimin në proceset gjyqësore apo administrative lidhur me shkeljet përkatëse doganore.
4. Autoriteti Kërkues nuk do të përdorë evidencat ose informacionin e përftuar sipas kësaj Marrëveshjeje për qëllime të tjera nga ato që janë paraqitur në kërkesë pa konsensusin paraprak të Autoritetit të Kërkuar.
5. Dispozitat e paragrafeve 3 dhe 4 të këtij Neni nuk do të zbatohen për informacione lidhur me shkeljet që kanë të bëjnë me lëndë narkotike dhe substanca psikotrope. Informacioni i kësaj natyre mund t'u komunikohet autoriteteve të Palës Kontraktuese Kërkuese të cilët kanë përfshirje direkte në luftën kundër trafikut ilegal të lëndëve narkotike.
6. Dispozitat e kesaj Marrëveshjeje nuk do të ndikojnë në dispozitat e aplikueshme për shkëmbimin e informacionit ndërmjet Komisionit European dhe Autoriteteve Doganore të Vendeve Anëtare të Komunitetit European lidhur me Shkeljet Doganore të interesit financiar për Komunitetin European.

SHPËRNDARJA E KONTROLLUAR

Neni 14

1. Palët Kontraktuese do të marrin të gjitha masat e nevojshme, brenda mundësive të tyre, për të lejuar përdorimin e përshtatshëm të shpërndarjes së kontrolluar për qëllime hetimesh kriminale.
2. Vendimet për kryerjen e shpërndarjes së kontrolluar do të merren rast pas rasti dhe në përputhje me legjislacionin vendas si dhe me procedurat e Palës Kontraktuese të Kërkuar, si dhe në përputhje me marrëveshjet apo rregullimet që mund të jenë arritur lidhur me çështjen konkrete.
3. Ngarkesat e paligjshme për të cilat është rënë dakort shpërndarja e kontrolluar, me konsensusin e ndërsjelltë të autoriteteve kompetente, mund të interceptohen dhe të lejohen të vazhdojnë me lëndet narkotike ose substancat psikotrope apo mallrat e tjera, të paprekura, të hequra apo të zëvendesuara tërësisht apo pjesërisht, siç mund të jetë rënë dakort ndërmjet Autoriteteve Doganore.

ZBATIMI

Neni 15

1. Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do t'i caktohet Autoriteteve Doganore të Palëve Kontraktuese. Ata do të vendosin mbi masat praktike dhe rregullimet e nevojshme për zbatimin e Marrëveshjes ose mbi çdo çështje tjetër doganore që mund të jetë me interes të ndërsjelltë.
2. Palet Kontraktuese mund të nxjerrin direktiva administrative të koordinuara për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe do të lehtësojnë koordinimin efektiv ndërmjet tyre, duke përfshirë shkëmbimin e personelit, ekspertëve dhe caktimin e punonjësve ndërlidhës. Autoritetet Doganore të Palëve Kontraktuese mund të vendosin që shërbimet e tyre të inteligjencës të jenë në komunikim direkt me njëri-tjetrin.
3. Autoritetet Doganore do të ndërmarrin përsipër me miratim të ndërsjelltë të zgjidhin problemet e dala nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje. Kjo nuk përjashton zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve me rrugë diplomatike.

HYRJA NE FUQI DHE PËRFUNDIMI**Neni 16**

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të tretë që nga data në të cilën Palët Kontraktuese kanë njoftuar njëra-tjetrën nëpërmjet shkëmbimit të notave diplomatike se janë përmbushur të gjitha procedurat e nevojshme ligjore kombëtare për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.
2. Palët Kontraktuese bien dakort të takohen me synim rishikimin e Marrëveshjes sipas kërkesës.
3. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë kohe të pakufizuar, nëse nuk përfundohet nga njëra prej Palëve Kontraktuese me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike. Marrëveshja do të pushojë së qeni në fuqi gjashtë muaj pas marrjes së një njoftimi të tillë.

NË DËSHMI TË SA MË SIPËR, përfaqesuesit nënshkrues, të autorizuar përkatësisht nga Qeveritë e tyre respektive, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bëre në Vjenë më datë 9. mars 2007, në dy kopje origjinale, në gjuhët Gjermane, Shqipe dhe Angleze, të gjitha tekstet njësoj të vlefshme. Në rast mosmarrëveshje në interpretimin teksti në gjuhën Angleze do të ketë përparësi.

Për Qeverinë e Republikës së Austrisë:

Për Këshillin e Ministrave
të Republikës së Shqipërisë:

Hans Winkler m.p.

Besnik Mustafaj m.p.

SHTOJCË

PARIMET BAZË TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE

1. Autoriteti që dërgon të dhëna do të sigurojë se të dhënat janë te sakta dhe të freskëta në kohë.
2. Nëse del se janë dërguar të dhëna të pasakta ose janë dërguar të dhëna të cilat nuk duhet të ishin dërguar ose, se të dhëna të komunikuar ligjshëm kërkohet në një fazë të mëvonshme të fshihen në përputhje me ligjin e Palës Kontraktuese dërguese, autoriteti marrës duhet të njoftohet menjëhere për sa më sipër. Ky autoritet do të jetë i detyruar t'i korrektojë këto të dhëna ose t'i fshijë ato.
3. Nëse autoriteti marrës ka arsye për të besuar se të dhënat e komunikuar janë të pasakta ose duhet të fshihen, ai duhet të njoftojë Palën Kontraktuese dërguese.
4. Sipas ligjeve të vendit, të dhënat e komunikuar do të mbahen në një database për një periudhë që nuk tejkalon periudhën e nevojshme për qëllimin për të cilin të dhënat janë dërguar.
5. Të drejtat e një personi të interesuar për të marrë informacion mbi të dhënat personale të komunikuar do të përcaktohen në përputhje me Legjislacionin Kombëtar, rregulloret dhe procedurat e Palës Kontraktuese në territorin e së cilës është kërkuar ky informacion. Përpara se të merret çfarëdolloj vendimi për dhënien e informacionit, autoritetit dërgues do t'i jepet mundësia të paraqesë qëndrimin e vet.
6. Në rastet kur të dhënat e komunikuar duhet të fshihen apo ndryshohen, në përputhje me ligjet e Palës Kontraktuese dërguese, personave të interesuar duhet t'u jepen të drejtat efektive për të korrektuar të dhënat.
7. Palët Kontraktuese do të jenë përgjegjëse, në përputhje me ligjet, rregulloret dhe procedurat e veta, për dëmtimet shkaktuar një personi si pasojë e përpunimit të të dhënave të dërguara në Palën Kontraktuese të interesuar.
8. Në vazhdim të parimeve të sipërpërmendura, do të zbatohen nga Republika e Shqipërisë parimet e Konventës Nr.108 të 28 Janarit 1981 të Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Individëve lidhur nga Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale, pas ratifikimit të kësaj Konvente.

9. Asnjë nga dispozitat e kësaj Shtojce nuk do të nënkuptohet se kufizon ose ndikon në mundësinë e një Pale Kontraktuese për tu dhënë subjekteve të të dhënave një masë më të gjerë mbrojtjeje se sa ato të përmendura në këtë Shtojcë.